



Komuna e Klinës



SHHBK "Nëna Tereze"

Letër zotimi

Në kuadër të Programit për dialog civil 2023-2026, ne jemi duke finalizuar negociatat për fillimin dhe zbatimin e projektit "Zhvillimi i mëtejshëm i dialogut civil mes Serbisë dhe Kosovës" ***Inkurajimi i angazhimit aktiv në dialogun civil brenda komuniteteve shumetnike në Serbi dhe Kosovë*** (për realizimin e hulumtimit në komunat ***Dragash, Prizren, Mamushë, Kamenicë, Novobërdë, Graçanicë, Shtrpcë, Obiliq, Klinë, Fushë Kosovë***).

Ky projekt përkrahët nga Bashkimi Evropian që përfaqësohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe do të zbatohet nga OJQ-ja e Kosovës (Shoqata Nëna Terezë) me përkrahje të OJQ-së nga Novi Sadi, Serbi (Qendra për Regjionalizëm). Ky projekt do t'i ketë shtatë faza.

1. Në fazën e parë do të bëhet nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për përkrahje në dialogun civil brenda komuniteteve shumetnike në Serbi dhe Kosovë;
2. Në fazën e dytë do të realizohet hulumtimi për gjendjen e të rinjve, grave dhe pakicave etnike në komunitete e përzgjedhura në Serbi dhe Kosovë;
3. Në fazën e tretë do të organizohen tryezat e rrumbullakëta për paraqitjen dhe diskutimin e të gjeturave të hulumtimit;
4. Në fazën e katërt do të ketë aktivitete të ngritjes së kapaciteteve për dialog civil me palët vendore me interes (pushteti lokal, institucionet publike, OShC-të e komuniteteve) përmes vizitave studimore në Serbi (Suboticë, Sentë dhe Zrenjanin) dhe Kosovë (Dragash, Fushë Kosovë dhe Novobërdë);
5. Në fazën e pestë do të përkrahen aktivitetet e përbashkëta në komunitetet e përzgjedhura shumetnike në Serbi dhe Kosovë, të cilat kontribuojnë në angazhimin aktiv të rinisë, grave dhe pakicave etnike;
6. Në fazën e gjashtë do të bëhet mentorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të përbashkëta të mbështetura;
7. Në fazën e shtatë do të organizohen konferencat përfundimtare në Serbi dhe Kosovë për të paraqitur rezultatet të përkrahjes së angazhimit aktiv për dialog civil në komunitetet shumetnike.

Periudha zbatuese e projektit është shkurt 2023 – janar 2026.

I nderuari kryetar,

Ne jemi në dijeni për përkushtimin tuaj dhe përpjekjet që i bëni për arritjen e një mirëqenieje ekonomike, sociale dhe politike, si dhe të stabilitetit për të gjithë qytetarët tuaj, me theks të veçantë tek grupet e pakicave në komunën tuaj.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projekti për komunën tuaj, ju ftojmë që ta përkrahni dhe të zotoheni për të, duke e nënshkruar këtë dokument, gjegjësisht që komuna juaj do të çojë përpara projektin **“Inkurajimi i angazhimit aktiv në dialogun civil brenda komuniteteve shumetnike në Serbi dhe Kosovë”** (për realizimin e hulumtimit në komunat **Dragash, Prizren, Mamushë, Kamenicë, Novobërdë, Graçanicë, Shtrpcë, Obiliq, Klinë, Fushë Kosovë**) – duke ndërmarrë hulumtimin në komunën tuaj në atë mënyrë që projekti assesi të mos komprometohet gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Shpresojmë që projekti të realizohet sipas planit të veprimit të tij.

Ne sinqerisht shpresojmë që komuna juaj do të jetë shembull i mirë për komunat e tjera shumetnike lidhur me hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Ju dëshirojmë sukses në punën tuaj!

Me nderime,

Zef Shala – drejtor ekzekutiv

Nënshkruar nga:

1. Kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj

Data: 30/03/2023

2. Sh.H.B Nëna Terezë, z. Zef Shala

Data: 30/03/2023

